



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.83/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkitazi me apelin Mustaf Bajraktaraj kryetar i subjektit politik Partia Republikane e Kosovës (PRK), paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të lejimit të pjesëmarrjes në zgjedhje në koalicion me Partinë Euro Atlantike (PEK) për Zgjedhjet e parakohshme Parlamentare që do të mbahen 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 23.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si i pasafatshëm apeli i identifikuar me numër: Anr.83/2019, i datës 23.09.2019, i parashtruar nga Mustaf Bajraktaraj.

A r s y e t i m

Me datë 23.09.2019, PZAP-i ka pranuar një apel nga Mustaf Bajraktaraj në të cilin pretendon se subjekti politik Republikanet e Kosovës, ka lidhur koalicion me subjektin politik PEK, me çka sipas parashtruesit të apelit kjo është duke shkaktuar huti tek opinioni i gjere i Kosovës dhe është duke i shkaktuar dëme të mediat Partisë Republikane të Kosovës (PRK).

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm

Paneli pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga Mustaf Bajraktaraj kundër vendimit të KQZ-së, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 122 par. 1 të LZP-së, ku përcaktohet: *“Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP brenda (24) orëve”*. Në këtë rast KQZ-ja, i ka certifikuar subjektet politike dhe koalicionet me datë 09.09.2019, për zgjedhjet parakohshme për Kuvend të Kosovës që do të mbahen me datë 06 tetor 2019, ndërsa apeli ndaj vendimit për certifikim është paraqitur me datë 23.09.2019, që rezulton të jetë pas afatit ligjor sepse afati për ankesa ka qenë 24 (njëzetekatër) orë nga marrja e vendimit të KQZ-së, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 122 paragrafi 1 të LZP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë ne kuptim të nenit 115 paragrafi 1, dhe nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 83/2019 me datën 23.09.2019



Kryesues i Panelit
Fejzullah Rexhepi

***Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*